





Publikuesi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Data e publikimit: Dhjetor, 2018

© Agjencia e Statistikave të Kosovës

Riprodhimi është i autorizuar me kusht që burimi të citohet

Informata më të detajuara gjinden në internet në ueb faqen:

<http://ask.rks-gov.net/>

## P a r a t h ë n i e

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), respektivisht Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit (DSBM) publikon Anketën e Mbeturinave Industriale (AMI) për vitin 2017 si anketë e rregullt vjetore.

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi statistikor është që të ofrojë të dhëna statistikore për mbeturinat e gjeneruara nga sektorët industrial në Kosovë. Ky hulumtim është kryer sipas NACE rev.2.

Rezultatet e paraqitura në këtë botim janë burim i rëndësishëm statistikorë për mbeturinat e gjeneruara dhe përpunuara nga sektorët e industrisë C, D, E, F, G-U.

Metodologjia e aplikuar për këtë hulumtimi është në përputhje me Rregulloren (EC) Nr 2150/2002 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të 25 Nëntorit 2002 mbi statistikave të mbeturinave, Listës Evropiane të Mbeturinave dhe Ligjit për Mbeturina në Kosovë Nr. 04 / L-060.

Falënderimet i dedikohen ekspertit nga GOPA Jürgen Gonser (ARGUS GmbH, Berlin) për mbështetje profesionale.

Ky publikim u përgatit nga:

Bajrush Qevani, Drejtor DSBM

Haki Kurti, MSc.Shef i Divizionit të Statistikave të Mjedisit

Ardianë Rashica, Zyrtare e Statistikave të Mjedisit

Sugjerimet, propozimet dhe vërejtjet për këtë publikim janë të mirëseardhura dhe mund të dërgohen me e-mail [agriculture@ksgov.net](mailto:agriculture@ksgov.net).

Dhjetor 2018

Kryeshef Ekzekutiv i ASK-së  
Z. Isa Krasniqi

## Shkurtesat dhe Simbolet

BE	-	Bashkimi Evropian
ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
NACE Rev.2.	-	Klasifikimi i Aktiviteteve Ekonomike
EWStat.	-	Classification.Katalogu Evropian i Mbeturinave
LoW	-	Lista e Mbeturinave
DSBM	-	Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit

## Simbolet

T	-	Ton
%	-	Përqindje
:	-	Të dhënat nuk janë në dispozicion

## **P ë r m b a j t a**

	Faqe
Informacione të përgjithshme .....	7
1. Objektivat dhe metodologjia e anketës .....	8
1.2 Metodologjia .....	9
2. Definicionet.....	10
3. Rezultatet e anketës së mbeturinave nga industria 2017.....	11
Shtojca1: Pyetësi.....	12

## **Informacione të përgjithshme**

Anketa e mbeturinave industriale në Kosovë u realizua sipas NACE Rev.2, i cili njëkohësisht është dhe klasifikim statistikor i aktiviteteve ekonomike. Mbeturinat janë klasifikuar si të rrezikshme dhe jo të rrezikshme, sipas listës së mbeturinave (LoW).

Njësi raportuese janë të gjitha kompanitë me 10 e më shumë punëtorë. Kompanitë e përfshira janë klasifikuar nga NACE Rev.2 në sektorët e aktiviteteve vijuese:

1. B- Xehetari dhe guroret
2. C- Prodhimit
3. D-Furnizimi me energji elektrike, gaz avull dhe furnizimi me ajër të kondicionuar.
4. E-Furnizimi me ujë, kanalizim, menaxhim i mbeturinave dhe rregullim toke
5. F - Ndërtimtaria
6. G-U - Sektorët e shërbimeve

## **1. Objektivat dhe metodologjia e anketës**

### 1.1 Objektivi

Objektivi i AMI 2017 është që të ofrojë të dhëna statistikore për mbeturinat e gjeneruara nga sektorët industrial në Kosovë, sipas NACE rev.2.. Rezultatet e paraqitura në këtë botim janë burim i rëndësishëm statistikorë për mbeturinat e gjeneruara dhe përpunuara nga sektorët e industrisë B, C, D, E, F, G-U.

Gjithashtu objektivi i AMI 2018 është, që anketimi të realizohet në përputhje me kërkesat për statistika në sektorin e mbeturinave në nivel vendi dhe njëkohësisht metodologjia e anketës të jetë në harmoni me rekomandimet ndërkombëtare për këtë sektor.



## **1.2 Metodologjia**

### **1.2.1 Korniza e anketës**

Të gjitha procedurat e hulumtimit dhe përgatitja e metodologjisë së AMI 2017 janë finalizuar gjatë muajit qershor 2018.

Mbledhja e të dhënave është kryer gjatë muajit korrik 2018, ndërsa intervistimi është realizuar sipas metodës tradicionale "Ballë për Ballë".

Plani i punës ka pasur këto faza:

1. Fazën përgatitore
2. Përgatitjen e mostrës
3. Trajnimin e anketueseve
4. Mbledhjes e të dhënave
5. Përpunimi i të dhënave dhe
6. Botimi-publikimi i rezultateve të anketës

Gjatë fazës përgatitore janë kryer këto aktivitete : mostra, pyetësoi, variablat, plani kohor, udhëzuesi për anketues, trajnimi i anketuesve dhe ndërtimi i bazës së të dhënave. Mostra është përgatitur sipas regjistrit statistikor për biznes.

Trajnimi është mbajtur një ditë në ASK, për të gjithë anketuesit të cilët kanë qenë të angazhuar në mbledhjen e të dhënave nga terreni.

### 1.2.2 Mbledhja e të dhënave

Mbledhja e të dhënave ka përfunduar nëpërmjet intervistimit “ballë për ballë”, me menaxherët e kompanive industriale që veprojnë në rajonin përkatës, bazuar në pyetësorë (Shtojca 1). Të gjithë pyetësorët janë kontrolluar për kontrollin e cilësisë në ASK, nga ekspertët e Divizionit të Statistikave të Mjedisit.

## 2. Definicionet

**Mbeturinat industriale:** mbeturinat e gjeneruara nga sektori i industrisë.

**Mbeturinat e rrezikshme:** mbetje e cila sjell dëm dhe rrezik për shoqërinë, e cila tregon rrezik domethënës për shëndetin njerëzor apo mjedisin kur nuk menaxhohet në mënyrë adekuate. Mbeturinat e rrezikshme janë të ndezshme, gërryese, reaktive ose toksike.

Mbeturinat e rrezikshme - janë mbeturinat të cilat kanë të paktën një nga karakteristikat e përshkruara si në vijim: shpërthyes, oksidante, djegëse, irrituese, e keqe, toksike, kancerogjene, gërryese, infektuese, teratogjerike, mutagjene, emetuese, gazra toksike në kontakt me ujin, ajrin ose një acid, ka të ngjarë të prodhojë substanca tjera të rrezikshme, dhe ekotoksike.

### 3.REZULTATET E ANKETËS SË MBETURINAVE NGA INDUSTRIJA 2017

Rezultatet nga AMI 2017, tregojnë se sasia mbeturinave industriale të gjeneruara ka qenë 2.606.203 ton, ndërsa sasia e mbeturinave të dërguara diku tjetër është 967.552 ton, mbeturina të deponuara 1.674.327 ton, mbeturina të ricikluara 3.193 ton, mbeturina të djegura 232 ton dhe gjithsej mbeturina të përpunuara 2.605.128 ton.

Tabela 3.1: Gjithsej sasia e mbeturinave industriale të gjeneruara nga sektorët e industrisë B.C.D.E.F.G-U, 2017.

NACE Rev.2	Mbeturina të gjeneruara	Trajtimi i mbeturinave nga kompanitë gjeneruese			Mbeturina të dërguara diku tjetër	Gjithsej mbeturina të përpunuara <sup>1</sup>
		Mbeturina të djegura	Të ricikluara	Të deponuara		
<b>Ton</b>						
B	90.292	5	8	88.693	1.606	90.312
CA	220.021	7	2	40.320	179.702	220.031
CB	119	3	10	:	102	115
CC	68.311	51	3.024	:	65.115	68.189
CE	63	1	:	:	62	63
CF	2	:	:	:	2	2
CG	43.282	23	107	682	41.717	42.528
CH	80.648	63	2	80.000	609	80.674
CI	5	:	:	:	5	5
CK	3	:	:	:	3	3
CL	65.004	:	:	:	65.004	65.004
CM	19.069	24	3	7	19.039	19.073
D	1.358.037	:	:	1.128.008	230.028	1.358.036
E	270.151	:	19	270.123	19	270.161
F	323.731	33	12	66.494	256.941	323.481
G-U	67.468	22	6	0	67.424	67.452
<b>Gjithsej:</b>	<b>2.606.203</b>	<b>232</b>	<b>3.193</b>	<b>1.674.327</b>	<b>967.552</b>	<b>2.605.128</b>

<sup>1</sup>)Përpunim i mbeturinave – operim, ku rezultati kryesor i të cilit është vënia në shërbim e mbeturinave për qëllime të dobishme, duke zëvendësuar materialet tjera të cilat përndryshe do të duhej përdorur për të plotësuar një funksion të caktuar, apo përgatitja e mbeturinës për të plotësuar ato funksione në ndonjë impiant apo ekonominë e gjerë. Shtojca II (Lista R – lista e operimeve potenciale).

## Shtojca1: Pyetëtori

# P Y E T Ë S O R

ANKETA E MBETURINAVE INDUSTRIALE 2017

### Identifikimi i biznesit:

Numri i biznesit

Numri Fiskal

Emëtimi i biznesit

Shifra e veprimtarisë: Nace Rev.2:

Numri i të punësuarëve 2017 (100% me orar të plotë)

Numri i të punësuarëve 2017 (me kohë të pjesshme)

Pershkrimi i aktivitetit ekonomik:

Adresa:

Komuna

Vendi

Rruga:

Numri i ndërtesës

Të dhënat e pronarit:

(Emri dhe Mbiemri)

E-mail dhe telefoni:

Personi kontaktues:

(Emri dhe Mbiemri)

Biznesi është anketuar

Po/Jo

Nëse jo, trego arsyen?

E-maili i personit kontaktues dhe telefoni:

Dita dhe koha e anketimit:

Data

Muaji

Viti

Koha

Gjenerimi dhe përpunimi i mbeturinave industriale 2017

(01.01-31.12.2017)

Gjenerimi i mbeturinave				Përpunimi i mbeturinave në kompani			Përpunimi i mbeturinave nga kompanitë tjera		
Kodi i mbeturinës (Plotësohet në ASK)	Lloji i mbeturinës	Mbeturina të gjeneruara (ton)	Mbeturina të marrura nga kompani tjera për trajtim (ton)	Të djegur (ton)	Të ricikluara (ton)	Të deponuar (ton)	Mbeturina të dërguara diku tjetër ( ton)	Dërguar diku tjetër, lloji i trajtimit	Komente nga anketuesi
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Gjithsej									

**Mbeturinat Komunale:**

1. Sa është sasia e mbeturinave komunale e prodhuar nga kompania juaj në vitin 2017. \_\_\_\_\_
2. Kush i grumbullon mbeturinat komunale në kompaninë/biznesin tuaj  
 2.1 Emri i kompanisë \_\_\_\_\_
3. Si është i menaxhuar grumbullimi i mbeturinave komunale në kompaninë /biznesin tuaj, nëse mbeturinat komunale nuk grumbullohen nga kompanitë për menaxhimin e mbeturinave. \_\_\_\_\_

**Sqarime:**

Çdo shënim, sugjerim apo mendim i juaji është i mirëseardhur me qëllim të përmirësimit të kualitetit të anketës së mbeturive industriale 2017.

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

**Anketuesi:**

\_\_\_\_\_  
*Emri dhe Mbiemri*

\_\_\_\_\_  
*Nënshkrimi*

## **Agjencija e Statistikave të Kosovës përshkrim i shkurtër**

**Agjencia e Statistikave të Kosovës**, është institucion profesional, i cili vepron që nga viti 1948 dhe ka kaluar disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe. Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën profesionale, si i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe donatorë për projekte të veçanta.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Plani zhvillimor strategjik 2009-2013 është në implementim afatmesëm për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

**Misioni i Agjencionit**, është që të përmbush nevojat e përdoruesve me të dhëna statistikore objektive dhe analiza të rregullta në mënyrë që të përkrah departamentet qeveritare, t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

**Adresa: Agjencia e Statistikave të Kosovës**

**Rr."Zenel Salihu" Nr.4, Prishtinë**

**Telefonat: +381 (0) 31 129**

**Kryeshefi ekzekutiv : +381 (0) 38 200 31 112**

**Fax: +381 (0) 38 235 033**

**E-mail: [infoask@rks-gov.net](mailto:infoask@rks-gov.net)**

**Ueb-faqe: <http://ask.rks-gov.net>**